

AKT THEMELIMI I SHOQËRISË
“Remark Contact” Sh.p.k

Në bazë e për zbatim të Ligjit 9901 dt 14.04.2008 “Per Shoqerite Tregtare dhe Tregtaret” si dhe legjislacionit ne fuqi te Republikes se Shqiperise me vullnetin tone te lire, ne:

Z. Sokol Pashaj, person fizik, datelindja 29.04.1971, lindur ne Shijak, identifikuar me leternjoftim nr. 029154660 nr identifikimi H10429161P, madhor, me zotesi të plotë juridike e për të vepruar,

vendosi të themeloje e formoje si subjekt, shoqërine tregtare me përgjegjësi të kufizuar **“Remark Contact” SH.P.K.**

NENI 1

Emri

Emri i shoqërisë së themeluar do të jete **“Remark Contact” SH.P.K**

NENI 2

Humbjet

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, i përballon humbjet e saj deri në kufirin e vlerës se kapitalit themeltar.

NENI 3

Selia

Selia dhe veprimtaria e e shoqërise do të jene në adresën : Rr “Prokop Mima”, Tirane, Selite, Njesia Administrative Nr: 5, Zona Kadastrale 3292, Nr. Pasurie 107/49+2-N13.

NENI 4

Kohëzgjatja

Veprimtaria e shoqërise eshte pa afat.

NENI 5

Objekti

Marrjen e te drejtes se perfaqesimit nga shoqeri qe veprojne jashte ose Brenda territorit te Republikes se Shqiperise per territorin e Republikes se Shqiperise. Investimin ne fusha te ndryshme, nepermjet shoqerive ku “Remark Contact” Sh.p.k eshte pronar ose bashkepronar si hidrokarburet,ndertimi, turizmi, brokerimi, marketing online te cilat perfaqesojne perkatesisht sherbimet Reklama & Marredhenieve me Publikun si dhe sherbimet ne lidhje me promovimin e shitjeve & Eventeve, pergatitjen,prodhimin,realizimin dhe mirembajtjen e faqeve te internetit dhe faqeve sociale si dhe realizimin e fushatave reklamuese online.

Zhvillim software, ne te gjitha platformat per web, desktop, mobile etj duke perfshire proceset e analizes , dezajn, planifikim, implementim, mirembajtje,telemarketing, sigurimi jetes ose sendeve, energjia. shendetesia. hoteleria, bare e restorante. Punesimi per te trete. Objekt i ketij aktiviteti do te jete cdo lloj aktiviteti i



ngjashem I lidhur si me siper qe do te konsiderohet i vlefshem nga vete politikat tregtare te shoqerise dhe qe nuk bien ndesh legjislacionin ne fuqi qe udheheq fushen e marredhenieve te tregtise se lire ne territorin e Republikes se Shqiperise.

NENI 6

Fillimi veprimtarisë

Aksioneri eshte dakort qe veprimtaria e dhene ne objektin e shoqerise do te filloje pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit.

NENI 7

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 200 000 (dy qinde mije) lekë, i cili perbehet nga kontributi i ortakut dhe ka 1 (nje) kuote i paguar plotesisht nga aksioneri i vetem.

Pjesa takuese e ortakut themelues eshte:

a) Z. Sokol Pashaj zoteron 100 % (njqind përqind) te kuotës e të kapitalit, duke pasur ne pronesi nje kuote.

NENI 8

Kapitali themeltar mund të shtohet ose zvogëlohet vetëm me vendimin e ortakut. Shtimi apo zvogëlimi i kapitalit themeltar do të bëhet në varesi të rezultateve ekonomike e në perputhje me normat e legjislacionit ne fuqi.

NENI 9

Forma ligjore e shoqerise: Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (SH.P.K.)

Ndryshimet e zotërimit dhe/ose përqindjes së kuotave, që ka aksioneri themelues, behet sipas legjislacionit ne fuqi.

NENI 10

Transferimi kuotave

Kuotat e kapitali themeltar, që ato përfaqësojnë, mund të transferohet me anë të shitjes dhurimit apo çdo mënyre tjetër të njohur nga legjislacioni Shqiptar vetëm më vendim unanim të ortakut. Bën perjashtim nga ky rregull vetëm kalimi me trashëgimi. Transferimi tek persona të tretë, shqiptar apo të huaj, i pjesëve të kapitalit dhe kuotës që ato përfaqësojne, bëhet me vendim unanim të ortakut.



Shoqëria ka si organe të saj:

a) Asambleja ortakeve

dhe

b) Administratorin.

Renditja e mësipërme shpreh dhe hierarkine e organeve drejtuese të shoqërise.

NENI 12

Administrator i shoqërise do jetë Z.Sokol Pashaj .

E gjithë veprimtaria e shoqërise administrohet nga administratori i saj në përputhje me statutin dhe legjislacionin në fuqi.

NENI 13

Vula

Shoqëria ka vulen e saj ku në brëndësi të saj jepet numri tatimor i shoqërise (NUIS).

PËRFUNDIMI SHOQËRISE

NENI 14

Shkrirja

Shoqëria mbaron me të përfunduar afati i parashikuar nga ky akt ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, me anë të një vendimi të ortakut të vetëm dhe për shkak të falimentimit.

NENI 15


Likuidimi

Në rast përfundimi, shoqëria do të nënshtrohet procedurave të likuidimit.

Për të administruar këtë procedure, administratori emerohet një ose disa likuidatore, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërise, mbi operacionet e likuidimit dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.

NENI 16

Shoqëria mund të mbarojë edhe me anë të riorganizimit, nepermjet formave të thithjes ose të bashkimit duke respektuar normat e ligjeve në fuqi.



NENI 17

Ky akt themelimi u përpilua nga aksioneri themelues i shoqërise me vullnetin e tij të plote e të lire.

Akti u përpilua në dy kopje të njejta, në përmbajtje e fuqi ligjore, ku një kopje do të dorëzohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, ndërsa kopja tjetër mbetet në dokumentacionin e shoqërise.

Tiranë më 21.10.2019

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE

Sokol Pashaj
Administrator

